

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut



POLITIKË **për zgjedhjen e shoqërisë për auditim të jashtëm të raporteve** **financiare të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së** **Veriut**

nëntor 2021

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 16) dhe në pajtim me nenin 65, paragrafi (3) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

P O L I T I K Ë

për zgjedhjen e shoqërisë për auditim të jashtëm të raporteve financiare të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i kësaj politike është të vendosë një kornizë gjithëpërfshirëse për zgjedhjen e shoqërisë për auditim të pavarur të jashtëm të raporteve financiare të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore).

2. Me politikën përcaktohen kërkesat dhe kushtet për zgjedhjen e shoqërisë për auditim, mënyrën e zgjedhjes, kohëzgjatja e marrëveshjes, rotacioni dhe përfundimi i kontratës me shoqërinë e zgjedhur për auditim, parimet e pavarësisë, si dhe shërbimet që nuk guxon ti kryej shoqëria e auditimit.

3. Komiteti i auditimit, në pajtim me kompetencat e dhëna nga Këshilli i Bankës Popullore¹, është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Politikës.

II. KËRKESAT DHE KUSHTET PËR ZGJEDHJEN E SHOQËRISË PËR AUDITIM

4. Për t'u kualifikuar për auditimin e pasqyrave të raporteve financiare të Bankës Popullore, shoqëria e auditimit duhet:

- Të ketë licencë pune dhe të jetë e regjistruar në Regjistrin e shoqërive për auditim në pajtim me dispozitat e Ligjit për Auditim;
- Të ketë përvojë ndërkombëtare të auditimit të institucioneve financiare dhe bankave qendrore, ku është e nevojshme të ketë audituar të paktën 1 (një) bankë qendrore (e cila nuk përfshin Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut) dhe të paktën 3 (tre) banka vendase afariste;
- Të ketë një ekip auditimi me përvojë të përbërë nga të paktën 7 persona, nga të cilët:

¹ Vendimi për formimin e Komitetit për auditim dhe përcaktim të fushëveprimit të tij V. nr.02-15/XIX-1/2021 nga 3 dhjetori 2021

- 5 auditorë, secili duhet të ketë përvojë pune të paktën 3 vite në auditimin e bankave. Të paktën dy prej tyre duhet të kenë një certifikatë për një auditor të autorizuar dhe njerëz të tjerë TI auditor me CISA (CISA – Certified Information Systems Auditor);
 - 1 auditor - partner, i cili duhet të ketë përvojë prej të paktën 5 viteve në auditimin e bankave dhe të paktën auditimin e një banke qendrore;
 - 1 auditor - për kontrollimin e cilësisë, i cili duhet të ketë përvojë prej të paktën 5 viteve në auditimin e bankave.
- Të jetë i pavarur gjatë aktivitetëve të auditimit, pra të jetë i pavarur dhe pa asnjë lloj ndikimi nga Banka Popullore.

III. MËNYRA E ZGJEDHJES SË SHOQËRISË PËR AUDITIM

5. Banka Popullore e bën zgjedhjen e shoqërisë për auditim përmes një procedure transparente, në pajtim me Ligjin aktual për Prokurim Publik.

IV. KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES, ROTACIONI DHE PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES ME SHOQËRINË PËR AUDITIM

6. Për hir të efikasitetit dhe efektivitetit më të madh, e njëjta shoqëri auditimit mund të kryejë auditime për disa vite radhazi, por jo më shumë se 5 vite radhazi.

7. Pas përfundimit të kohëzgjatjes maksimale prej 5 vitesh radhazi, shoqëria për auditim që deri atëherë ka kryer auditime nuk mund të rishikojë pasqyrat financiare të Bankës Popullore, të paktën 2 vite nga data e përfundimit të marrëveshjes së fundit.

8. Ndërprerja e parakohshme e marrëveshjes me auditorin e jashtëm mund të ndodhë në përputhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshjen e prokurimit publik dhe dokumentacionin e tenderit, Ligjin për Prokurim Publik dhe Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Diferencat në opinionet ndërmjet shoqërisë së auditimit dhe Bankës Popullore në raport me trajtimin kontabël apo procedurat e auditimit nuk mund të jenë arsye për ndërprerjen e marrëveshjes.

V. KORNIZA KOHORE PËR KRYERJEN E AUDITIMIT

9. Auditimi kryhet çdo vit sipas afatit kohor të mëposhtëm:

- Auditimit të mëparshëm që nga tremujori i tretë i vitit për të cilin është kryer auditimi: fillon të kryhet gjatë nëntorit;
- Raporti i gjetjeve të auditimit të mëparshëm (nëse ka): gjatë dhjetorit;
- Projekt letër për menaxhmentin e Bankës Popullore: gjatë dhjetorit;
- Auditimi përfundimtar dhe auditimit i raporteve financiare të Bankës Popullore të përgaditura në pajtim me MSFI-në dhe llogarinë vjetore: fund të janarit dhe gjatë shkurtit të vitit të ardhshëm;
- Projekt-raport për auditimin: deri 20 shkurt;
- Raport përfundimtar i auditimit: deri 25 shkurt;

- Letër deri te menaxhmenti i Bankës Popullore: deri 20 mars;
- Raport për pajtueshmërinë e Raportit Vjetor të Bankës Popullore me Raportet financiare dhe llogarinë vjetore: deri 25 prill.

VI. PARIMI I PAVARËSISË

10. Shoqëria e përzgjedhur e auditimit dhe anëtarët e ekipit të auditimit duhet të kryejnë aktivitetet e auditimit në pajtim me rregullativën vendase, me Standardet ndërkombëtare të auditimit dhe Kodin e Etikës për Kontabilistë Profesional të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve².

11. Shoqëria e përzgjedhur e auditimit duhet të jetë e pavarur nga Banka Popullore, veçanarisht:

- Në periudhën e angazhimit të auditimit dhe në vitin të të cilit raportet financiare janë objekt i auditimit, nuk duhet të ketë marrëveshje tjera për shërbime me Bankën Popullore, të përcaktuara në pikën 14 të kësaj politike;
- nuk duhet të përfshihet në asnjë mënyrë në procesin e vendimmarrjes në Bankën Popullore;
- anëtarët e ekipit për auditim nga shoqëria e auditimit nuk duhet të kenë konflikt interesi me menaxhmentin e Bankës Popullore.

12. Partneri i auditimit nuk guxon të zërë një pozite kyçe drejtuese në Bankën Popullore, të paktën për një periudhë dyvjeçare pas përfundimit të marrëdhënies së tij afariste si partner për auditim të shoqëria për auditim.

13. Shoqëria për auditim është detyruar të paraqesë deklaratë me shkrim deri te Banka Popullore njëherë në vit:

a) shoqëria për auditim e vërteton pavarësinë e saj nga Banka Popullore. Bashkangjitur me këtë deklaratë për pavarësi janë edhe deklaratat për pavarësi të çdo anëtari të angazhuar në ekip;

b) shoqëria e auditimit shpalos të gjitha kushtet kontraktuale të cilat i siguron për Bankën Popullore, përkrah auditimit ligjor (nëse ka të tilla, ose jep deklaratë se nuk ka).

VII. SHËRBIME TJERA QË NUK DUHET TI KRYEJ SHOQËRIA PËR AUDITIM

14. Shoqëria e auditimit në pajtim me pikën 11) paragrafi (1) nga kjo politikë nuk duhet të kryej shërbime tjera kontraktuale me Bankën Popullore të cilat mund ta kërcënojnë pavarësinë dhe objektivitetin e auditimit, siç janë:

- shërbimet kontabël (mbajtja e kontabilitetit dhe hartim të evidencës së kontabilitetit dhe raporteve financiare;
- shërbime lidhur me funksionin e auditimit të brendshëm të subjektit të auditimit;

² "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 135/11, 188/13, 43/14, 138/14, 145/15, 192/15, 23/16 dhe 83/18 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 122/21.

- hartimin dhe zbatimin e procedurave të kontrollit të brendshëm ose për menaxhimin e rrezikut, lidhur me hartimin dhe/ose kontrollimin e informacioneve financiare ose hartimin dhe zbatimin e sistemit për teknologji informatike në fushën e financave;
- shërbime për vlerësimin e vlerës së mjeteve dhe detyrimeve,
- shërbime juridike lidhur me sigurimin e konsultimeve nga karakteri i përgjithshëm dhe përfaqësimin gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
- shërbime të cilat përfshijnë çfarëdo roli në menaxhim ose vendimmarje në Bankën Popullore;
- shërbime nga fusha e menaxhimit me burimet njerëzore;
- shërbime për llogaritjen e pagës dhe
- shërbime tatimore.

15. Shoqëria për auditim, me miratim paraprak nga Banka Popullore, mund të jep shërbime tjera jo audituese, përveç atyre të përcaktuara në pikën 14) nga kjo politikë, nëse vlerësohet se janë në kundërshtim me parimin e pavarësisë.

VIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

16. Kjo politikë hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Pl. Nr. 02-15/XIX-1/2021
3 dhjetor 2021
Shkup

Guvernatorja
dhe Kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска